



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:232073
Datë: 06.08.2024
Numri i dokumentit: 06022979

C.nr.935/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F..B..nga fsh.D.. e M.., K.L.të cilIn me autorizim e përfaqëson av. Marigona Gashi me seli në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i shujtave ditore, jashtë seance gjyqësore, me dt.06.08.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

- I.** **APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit F.. B.. nga fsh.D.. e M..K.L..si e bazuar.
- II.** **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t'ia paguaj për 70 ditë të punës për periudhën nga data 11.05.2022 deri me dt.18.11.2022 të përllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë shumën e përgjithshme prej **140.00-€**, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt. 07.11.2022, e deri në përbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- III.** **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 176.00-€.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave ditore, sipas padisë paditësja është mësimdhënëse në Sh.F.M.U. “2 D...” në fsh.D..e M.. K... dhe i njëjtë i plotëson kushtet e përfitimit të shujtës ditore sipas kushteve të parapara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendon se i takon kompensimi i ushqimit në punë-shujtave ditore.

E autorizuara e paditësit përmes parashtresës së datës 20.11.2023 ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që t'ia kompensoj paditësit për 70 ditë të punës për periudhën nga data 11.05.2022 deri më dt.18.11.2022 të përllogaritur sipas shumës

nga 2 euro në ditë shumën e përgjithshme prej 140.00-€, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.03.08.2022, si dhe shpenzimet e procedures.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njofuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 25.04.2023, e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L-212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës te cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive ne nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditures nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruuese të Kontratës Kolektive. I ka propozuar gjykatisë që konform dispozitave ligjore të LPK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditëses ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: “*po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim*”, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë (më tej KKAK) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës, me datën 22.01.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: kontrata e punës nr.04-112-813.., e dt.01.09.2016, vërtetimin nr.2295/1, të dt. 24.10.2023, të lëshuar nga Sh.F.M.U. “2 D..” në fsh. D..e M..e K. L..., për 70 ditë punë efektive nga dt. 11.05.2022 deri me dt.18.11.2022.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi ka gjithsej 229 pune dite efektive tek e paditura në Sh.F.M.U. “2 D..” në fsh.D..e M..e, K.L.., mirëpo kontestuese është kompensimin i mjeteve në emër të shujtave ditore, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK-ut, ku me dispoziten e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, Shkolla Speciale e Qendra të Kompetencës) dhe Institucione të Arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj Kontratë Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit të lartë, MASHT-in etj) ne sektorin publik dhe

institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas nenit 35 par.7 si dhe par.8 pikë 8.1 në të cilën përcaktohet se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”, andaj kjo gjykatë vlerëson se paditësesi takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës, përkatësisht për periudhën si në al.II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar dhe nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkësen për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t'a aprovojë për periudhën si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

Poashtu poqëse e paditura e konteston kërkësepardinë, përgjigja në padi duhet t'i përbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tillë”, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtresës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Andaj, meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjendën në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e pjesërishtëm të kërkësepredisë së paditësit.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me ate se komuna nuk është nënshkruese e kontratës kolektive se nuk kanë parapara mjete financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve, por gjykata pretendimet e tillë i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollar, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se “Dispozitat e e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” prandaj është edhe irelevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Gjykata për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 07.11.2022, dita e paraqitjes së kërkësepredisë në këtë gjykatë, e deri në përbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditëses ju pranohen shpenzimet procedurale dhe atë ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t'ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 78.00-€ në emër të parashtrimit të padisë, për parashtresë për precizimin e kërkespadisë shumën prej 78.00-€, sipas TOAK-së si dhe shumën prej 20.00-€ në emër të taksës gjyqësore, e në total shuma prej 176.00-€.

Duke u bazuar në të dhënrat e lartcekura, gjykata ka vendsur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.935/2022 me datën 06.08.2024

**Gjyqtari
Zenel Tasholli**

Udhëzim juridik:

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.